



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 65 dt.28.06.1995

PER
SHTESE PENSIONI PER MERITA TE VECANTA

Këshilli Bashkisë Tiranës, në mbledhjen e dt.28.06.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Organizim Personelit për shtesë të veçantë për familjen e Dëshmorit Idriz Hoxha në masën që parashikon V.K.M. Nr.272, dt.21.06.1994 “Për pensionet e veçanta”

Vëren se :

Pilotit Idriz Hoxha, për aktin heroik që tregoi duke rënë dëshmor në krye të detyrës gjatë një fluturimi, i cili u rrëzua bashkë me aeroplanin dhe u mbyt në det, dhe si njeri e specialist me ndjenjë të lartë patriotizmi që ka dhënë kontribut në ecjen e proceseve demokratike, shembull pune si mësues i palodhur që ka përgatitur breza të rinj aviatorësh, Këshilli ynë e ka shpallur “Dëshmor të Atdheut” dhe Këshilli i Ministrave me Propozim po të Këshillit tonë i ka akorduar familjes së tij një pension të veçantë prej 1.920 lekë.

Me daljen e vendimit Nr.272, dt.21.06.1994 të K.Ministrave “Për pensionet e veçanta” masa e këtij pensioni është rritur, kështu që edhe familjes së dëshmorit Idriz Hoxha, duhet tu rritet ky pension në masën që parashikon vendimi i mësipërm, mbasi pensioni i akorduar është tepër i ulët.

Në këto kushte mbështetur në VKM Nr.272, dt.21.06.1994 si dhe në bazë të nenit.14, të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 Këshilli i Bashkisë Tiranës

VENDOSI

- 1.** Ti propozojë Këshillit të Ministrave që familjes së Dëshmorit të Atdheut, Pilotit Idriz Hoxha, ti rritet pensioni “Për merita të veçanta” në masën që parashikon ky vendim, dmth 8.800 lekë në muaj.
- 2.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA